



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2168/2 prot.,

Datë 01.08.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Climacasa” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-11470-06-28-2024, me objekt:“ Riparim Mirëmbajtje të sistemit Ngrohje – Ftohje për SUT”, me fond limit 8,122,756.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 11.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Climacasa” SHPK me NIPT L07805502F dhe adresë: Lagjja Beselidhja, Rruga "Shtraus", Pallati Nr. 1, kati perdhe, Lezhë.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.
Blv. “Dëshmorët e Kombit” Tiranë

Në datën 31.07.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4393, si dhe nr.2168/2024 prot, datë 31.07.2024 i operatorit ekonomik “Climacasa” SHPK, në procedurën e prokurimit E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-11470-06-28-2024, me objekt:“ Riparim Mirëmbajtje të sistemit Ngrohje – Ftohje për SUT”, me fond limit 8,122,756.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 11.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Climacasa” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Climacasa” SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik "CLIMACASA" sh.p.k. me NUIS L07805502F, me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DT, argumentuar si vijon:

- Operatori ekonomik nuk ka deklaruar personin “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” sipas pikës 2.3.5 të seksionit 2.3 Kapaciteti Teknik të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit të përcaktuara në DT ku operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij personel të kualifikuar/çertifikuar, 1 (një) punonjës përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë, i cili të jetë i çertifikuar “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e ligjit nr.10327 date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 01.08.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro